



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 465-32876/2020

Klinë, dt. 12.11.2020

Duke u bazuar në nenin 5, 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nr. 03/L-154, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, më dt. 12.11.2020, **merr këtë;**

V E N D I M

1. **OBLIGOHET**, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi që përmes shërbimit profesional pronëso- juridik të saj, e në bashkëpunim edhe me resorët tjerë kompetent, të ndërmerr veprimet e nevojshme procedurale, kundër të gjithë uzurpuesve eventual të identifikuar dhe shfrytëzuesve të pronave publike të Komunës së Klinës, më qëllimin e tërheqjes së vërejtjes dhe paralajmërimit së titullari ekskluziv i pronës publike është e komuna e Klinës dhe si e tille është e patjetërsueshme në tretmanin e pronësisë private.
2. Drejtoria përkatëse merr obligim qe per secilin shfrytëzues apo uzurpues eventual te pronës së komunës së Klinës, te paraqes tërheqjen e vërejtjes lidhur më të drejtat pronësore, të cilat vërejtje evidentohen në protokoll si dhe më rastin e dorëzim pranimit nga pala të jete i evidentuar pranimi i saj.
3. Per kryerjen e këtyre veprimeve autorizohet Drejtoria e Kadastrit qe sipas nevojës të formoj komisione dhe të ndërmerr veprime të nevojshme procedurale në përputhje më autorizimet ligjore me qëllimin e evitimit te pasojave të mundshme juridike qe rrezikojnë pronën publike.
4. Lidhur më kryerjen e këtyre obligimeve kryetari i komunës njoftohet më raport zyrtar detal në një afat sa më të shkurtër të mundshëm.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Kadastrit;
- Ekzekutivi;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj